

VENDIM
Nr.783, datë 14.12.2005

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË
INSTITUCIONET SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19 shkronja “c”, 20 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të neneve 82 e 85 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 2 të kreut I të këtij vendimi, të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Përjashtim nga zbatimi i orarit të përcaktuar më lart bëjnë postet konsullore, në përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, të Republikës së Shqipërisë (konsullatat e përgjithshme, konsullatat, nënkonsullatat dhe zyrat konsullore).

Në këto poste konsullore orari i punës të jetë:

- Çdo të mërkurë, të enjte, të shtunë dhe të dielë nga ora 9⁰⁰ deri në orën 14⁰⁰ dhe nga ora 14.30 deri në orën 17.30;

- Çdo të premte nga ora 14⁰⁰ deri në orën 22⁰⁰.”.

2. Në fund të pikës 1 të krut II, të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Për postet konsullore, në përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, të Republikës së Shqipërisë, (konsullatat e përgjithshme, konsullatat, nënkonsullatat dhe zyrat konsullore) ditët e pushimit javor janë vetëm dita e hënë dhe e martë e çdo jave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha